

VENDIM
Nr. 686, datë 6.11.2024

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION RRUGE, FSHATI DRENOVICË”, BASHKIA
DIMAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksion rruge, fshati Drenovicë”, Bashkia Dimal.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Dimal.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 750 494 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 750 494 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Dimal.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Dimal.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Dimal.
 8. Bashkia Dimal kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Dimal.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Dimal për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Dimal për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Dimal, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARIT, TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHET PËR INTERES PUBLIK PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSION RRUGE, FSHATI DRENOVICË”, BASHKIA DIMAL

Nr.	Pronari			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)										TRUALL			NDËRTESË			SHËNIME (Në lidhje me kushtet hipotekare, burimet e pasurisë etj.)
	Emri	Aftësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Gjimi (ekz/m ²)	Vlera (€SH)	Sipërfaqja (m ²)	Gjimi (ekz/m ²)	Vlera (€SH)	VLERA TOTALE (€SH)	
1	Xhacumi	Ali	Salvan	Katall	2349	45/7	Truall	84	84	84	8	44	84	203	17,052	84		1,733,442	1,750,494	Konfirmuar nga ASHRC-sh
VLERATOTALE														17,052			1,733,442	1,750,494		